



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 24 (827722)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 11 Qershor 2021

Ministri Peleshi vizitë zyrtare në Letoni



Do të vijojmë kontributin në misionin e NATO-s në veri të Europës

Pas vizitës zyrtare në Estoni, ministri i Mbrojtjes zoti Niko Peleshi me ftesë të homologut të tij zotit Artis Pabriks, vijoi vizitën më 4 qershor në Letoni. Dy delegacionet zhvilluan një takim miqësor, në të cilin patën mundësinë të ndanin mendimet dhe idetë e tyre për të zhvilluar dhe intensifikuar më tej bashkëpunimin

në fushën e Mbrojtjes, ku interes të veçantë përbëjnë fushat e arsimit ushtarak dhe komunikimit strategjik. Zoti Peleshi shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vijueshme që Letonia i ka dhënë Shqipërisë jo vetëm gjatë procesit të anëtarësimit në NATO, por edhe në përpjekjet që vendi ynë po... >>> faqe 2

Ministri Peleshi i jep "Medaljen e Mirënjohjes"

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Air Chief Marshal Sir Stuart Peach mbyll mandatin



>>> faqe 2

Ministri Peleshi, vizitë zyrtare dy ditore në Estoni

Ushtarakët tanë do të trajnohen në Qendrën e Ekselencës së Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s

Ministrat Peleshi dhe Kalle Laanet vlerësuan kontributet respektive dhe pjesëmarrjen ndër vite, në misionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB >>> faqe 3



Stërvitja "Defender Europe 21"

Trupat tona në Kroaci: Përfundon stërvitja e zbulimit "Laufer-21"

Në kuadër të paketës së stërvitjeve "Defender-21", në periudhën 16-29 maj në Kroaci u zhvillua stërvitja ndërkombëtare e zbulimit "Laufer-21". Në këtë stërvitje Shqipëria u prezantua me një personel prej 11 ushtarakësh, efektivë të Kompanisë së Zbulimit të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS). Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte ndërveprueshmëria midis trupave të...



>>> faqe 4

Analizë

BCU në stërvitjen "Defender Europe 21"

Stërvitja "Defender Europe 21", është pa dyshim stërvitja shumëkombëshe më e madhe, e zhvilluar ndonjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në rajonin tonë, në tre dekadat e fundit, si për forcat pjesëmarrëse dhe mjetet e dislokuara, ashtu dhe për forcat dhe mjetet që do të kryenin kalimin transit në vendin tonë. Në vendin tonë pati disa zona stërvitjeje si Zall Herr...

>>> faqe 6-7

Jens Stoltenberg në Shtëpinë e Bardhë

Një NATO e fortë është e mirë për Europën dhe për SHBA-në

>>> faqe 12

GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ VIZITË NË KOMANDËN E KFOR-IT

Gjeneralmajor Federici vlerëson personelin ushtarak që shërben në KFOR

faqe 4

SARAJEVË, BOSNJË-HERCEGOVINË

Gjeneralmajor Begaj në Konferencën e 14-të të Shefave të Shtabit të Vendeve Ballkanike

faqe 5



Ministri Peleshi i jep "Medaljen e Mirënjohjes"

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Air Chief Marshal Sir Stuart Peach mbyll mandatin

Air Chief Marshal Sir Stuart Peach do t'i dorëzojë detyrën e kryetarit të Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiralit Rob Bauer, deri tani shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Holandës

Kontributi i kryetarit të Komitetit Ushtarak të NATO-s, Air Chief Marshal Sir Stuart Peach për forcimin e marrëdhënieve të FA-së shqiptare me ushtritë e tjera aleate, bëri që ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi t'i akordonte atij "Medaljen e Mirënjohjes".

Gjatë vizitës së tij në vendin tonë, që përkon edhe me përfundimin e mandatit të tij në krye të Komitetit Ushtarak të NATO-s, Air Chief Marshal Sir Stuart Peach u prit më 7 qershor 2021, nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj.

Ministri Peleshi e cilësoi si shumë të veçantë vizitën e gjeneralit britanik, i cili mori besimin për të kryesuar Komitetin Ushtarak të NATO-s pikërisht në Tiranë, në shtator të vitit 2017.

Zoti Peleshi e përgëzoi Air Chief Marshal Sir Stuart Peach për liderimin dhe profesionalizmin me të cilin ai drejtoi për gati katër vite këtë forum të rëndësishëm të Aleancës dhe për objektivat e arritura.

Air Chief Marshal Sir Stuart Peach do t'i dorëzojë detyrën e kryetarit të Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiralit Rob Bauer, deri tani shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Holandës.



Ministri Peleshi vizitë zyrtare në Letoni

Do të vijojmë kontributin në misionin e NATO-s në veri të Europës

Ministrat Peleshi dhe Pabriks shprehën gatishmërinë për të mbështetur vendimet dhe angazhimet që priten të konfirmohen në Samitin e NATO-s në Bruksel

Pas vizitës zyrtare në Estoni, ministri i Mbrojtjes zoti Niko Peleshi me ftesë të homologut të tij zotit Artis Pabriks, vijoi vizitën më 4 qershor në Letoni. Dy delegacionet zhvilluan një takim miqësor, në të cilin patën mundësinë të ndanin mendimet dhe idetë e tyre për të zhvilluar dhe intensifikuar më tej bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes, ku interes të veçantë përbëjnë fushat e arsimimit ushtarak dhe komunikimit strategjik.

Zoti Peleshi shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vjueshme që Letonia i ka dhënë Shqipërisë jo vetëm gjatë procesit të anëtarësimit në NATO, por edhe në përpjekjet që vendi ynë po bën për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian.

Të dy ministrat vlerësuan kontributet respektive në angazhimet në kuadër të Aleancës si edhe shprehën gatishmërinë për të mbështetur vendimet dhe angazhimet që priten të konfirmohen në Samitin e NATO-s në Bruksel.

Ministri i Mbrojtjes rikonfirmoi vijimin e prezencës me një togë EOD në Camp Adazi, në



kuadër të misionit të NATO-s "enhanced Forward Presence". Ai falënderoi ministrin Pabriks për

të gjithë mbështetjen që pala letoneze i siguron kontingjentit shqiptar, në mënyrë të veçantë gjatë

ngjarjes tragjike të ndodhur dy vite më parë, ku humbën jetën dy ushtarakë shqiptarë.

Pas takimit në Ministrinë e Mbrojtjes, zoti Peleshi udhëtoi për në Camp Adazi, ku u takua me zyrtarët ushtarakë letonezë dhe drejtuesit kanadezë të grup-batalionit. Në takimin me kontingjentin shqiptar, ministri përgëzoi personelin e FARSH në misionin "enhanced Forward Presence" për kontributin në mbrojtjen kolektive, profesionalizmin e tyre si edhe për vlerësimin e lartë që ata kanë tek kolegët e vendeve partnere. Ministri i Mbrojtjes vendosi një kurore me lule në memorialin e dëshmorëve të atdheut, major Klodian Tanushi dhe nëntetar Zarife Hasanaj, të cilët ranë në krye të detyrës dy vjet më parë.

Ministri Peleshi, vizitë zyrtare dy ditore në Estoni

Ushtarakët tanë do të trajnohen në Qendrën e Ekselencës së Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s

Ministrat Peleshi dhe Kalle Laanet vlerësuan kontributet respektive dhe pjesëmarrjen ndër vite, në misionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, në datat 2-3 qershor, zhvilloi një vizitë zyrtare në Estoni, ku gjatë takimit me homologun Kalle Laanet, shprehu mirënjohjen për mbështetjen e jashtëzakonshme diplomatike të Estonisë për Shqipërinë dhe faktorin shqiptar në rajon.

Peleshi vlerësoi Estoninë si një nga vendet që shprehet qartë për domosdoshmërinë e integritet të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian duke e konsideruar procesin e hapjes së negociatave thelbësor për paqen dhe sigurinë në rajon.

Të dy ministrat e Mbrojtjes vlerësuan kontributet respektive dhe pjesëmarrjen ndër vite, me një numër të konsiderueshëm trupash, në misionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB.

Ata rikonfirmuan qëndrimin se do të vijojnë të jenë mbështetës të çdo vendimi që Aleanca do të marrë në lidhje me Afganistanin, tashmë që misioni Rolute Support përfundoi si edhe të çdo vendimi tjetër që pritet të merret në Samitin e Brukselit, me fokus në agjendën e NATO 2030.

Ministri i Mbrojtjes Peleshi theksoi angazhimin për intensifikimin e marrëdhënieve bilaterale në fushën e mbrojtjes me Estoninë. Në mënyrë të veçantë biseda u përqendrua në mundësitë e mbështetjes me kurse dhe trajnime të personelit shqiptar në Qendrën e Ekselencës së NATO-s për Cyber Defense, (NATO Center of Excellence for Cyber Defense, Tallinn), një sfidë e re kjo për Shqipërinë.

Pas takimit në Ministrinë e Mbrojtjes së Estonisë delegacioni shqiptar zhvilloi një vizitë në Kolegjin Baltik të Mbrojtjes, në Tartu të Estonisë, ku u trajtuan gjerësisht mundësitë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencës me Akademinë e Forcave të Armatosura në Tiranë. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi shoqërohej nga Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, Gjeneral Brigadë Albert Mullai.



Ministri Peleshi në Kolegjin Baltik të Mbrojtjes



AFA do të bashkëpunojë me Kolegjin Baltik të Mbrojtjes

Gjatë vizitës në Estoni, Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi i shoqëruar nga Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, Gjeneral Brigadë Albert Mullai, ka zhvilluar në 3 qershor 2021, një vizitë në Kolegjin Baltik të Mbrojtjes (BALTDEFCOL).

Gjatë vizitës, Gjeneral Brigadë Ilmar Tamm, Komandanti i Kolegjit Baltik të Mbrojtjes, me praninë e anëtarëve të Grupit të Menaxhimit të Kolegjit dhe një informim dhe prezantoi Kolegjin si organizatë rajonale për Arsimin Ushtarak Profesional (PME) dhe theksoi rolin e Kolegjit në sistemin e edukimit ushtarak. Paraqitja përfshiu një përmbledhje të strukturës së arsimit, duke përfshirë kurse të certifikuar nga NATO dhe ESDC, dhe përparësitë e kërkimit. "Që nga themelimi, shtatë studentë shqiptarë kanë marrë pjesë në kurset tona kryesore dhe që nga viti 2016 flamuri shqiptar përfaqësohet brenda anëtarëve të familjes BALTDEFCOL", -tha gjeneral brigadë Ilmar Tamm.

Shkurtimisht u pasua nga shkëmbimi i përvojave në lidhje me arsimin ushtarak, i cili lidhet me zhvillimin e vazhdueshëm të Arsimit Ushtarak Profesional (PME) në Shqipëri. Fushat e interesit mbuluan të gjitha nivelet e arsimit ushtarak me fokus specifik: sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të personelit ushtarak. Të dy drejtuesit e strukturave ranë dakord për të zgjeruar bashkëpunimin në të ardhmen bazuar në identifikimin e interesave dhe mundësive të ndërsjella në lidhje me arsimin dhe kërkimin shkencor ushtarak. Gjeneral Brigadë Ilmar Tamm, ka ftuar ushtarakët shqiptarë në Kolegjin Baltik të Mbrojtjes për të ndjekur aktivitetet specifike arsimore, si pjesë e shkëmbimit të përvojave. Vizita përfundoi me një shprehje të ndërsjellë të qëllimit për të vazhduar dhe intensifikuar bashkëpunimin midis dy institucioneve ushtarake.

Çfarë është Qendra e Ekselencës e Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s?

Qendra e Ekselencës së NATO-s, për Cyber Defense, është e vendosur në Talin, Estoni. Qendra u krijua në 14 maj 2008, ajo mori akreditim të plotë nga NATO dhe arriti statusin e Organizatës Ushtarake Ndërkombëtare në 28 Tetor 2008. Qendra e Ekselencës së NATO-s për Mbrojtjen Kibernetike është një Organizatë Ushtarake Ndërkombëtare me një mision për të rritur aftësinë, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit midis NATO-s, kombeve të saj anëtare dhe partnerëve në mbrojtjen kibernetike me anë të edukimit, kërkimit dhe zhvillimit, mësimëve të marra dhe konsultimit.

Në vitin 2003, përpara hyrjes zyrtare në NATO, Estonia propozoi krijimin e një Qendre të Ekselencës për mbrojtjen kibernetike. Takimi i nivelit të lartë të Rigës në vitin 2006 renditi sulmet e mundshme kibernetike midis kërcënimeve asimetrike ndaj sigurisë së përbashkët dhe pranoi nevojën për programe për të mbrojtur sistemet e informacionit për një periudhë afatgjatë. Sulmet kibernetike ndaj Estonisë në 2007 nxorën në pah për herë të parë cenueshmërinë e mundshme të cilido vend të NATO-s, in-



stitucioneve dhe shoqërive të tyre, madje edhe vetë NATO-s për përçarjen ose depërtimin e sistemeve të tyre të informacionit dhe komunikimit. Në janar 2008, NATO miratoi politikën mbi mbrojtjen kibernetike çka i hapi rrugë miratimit të Estonisë për ngritjen e Qendrës së Ekselencës për Mbrojtje Kibernetike në Talin. Komunikata e Samitit të NATO-s në Bukuresht në muajin prill 2008, njoftoi gatishmërinë e NATO-s për "të siguruar një aftësi për të ndihmuar kombet aleate,

me kërkesë, për t'iu kundërvënë një sulmi kibernetik".

Kombet themelues të Qendrës së Ekselencës për Mbrojtjen Kibernetike të NATO-s (NATO Center of Excellence for Cyber Defense, Tallinn), ishin Estonia, Gjermania, Italia, Letonia, Lituania, Sllovakia dhe Spanja. Më pas, gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2019 u bashkuan shumë vende të tjera duke e çuar numrin e tyre në 25. Konkretisht ato janë: Estonia, Gjermania, Italia, Letonia, Lituania, Sllovakia, Spanja, Hungaria, Polonia, Shtetet e Bashkuara, Holanda, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Republika Çeke, Austria, Finlanda, Greqia, Turqia, Bullgaria, Danimarka, Norvegjia, Rumania, Belgjika, Suedia dhe Kanadaja. Katër anëtarë të rinj, iu shtuan grupit në qershor 2019 dhe ato ishin: Bullgaria, Danimarka, Norvegjia dhe Rumania duke e çuar numrin e tyre në 25. Anëtarësimi është i hapur për të gjitha vendet e NATO-s, por edhe partnere. Gjithashtu mund të krijojë marrëdhënie bashkëpunimi me kombe jo-të NATO-s, universitete, institucione kërkimore dhe biznese si Pjesëmarrës Kontribues.

Gjeneralmajor Bajram Begaj vizitë në Komandën e KFOR-it

Gjeneralmajor Federici vlerëson personelin ushtarak që shërben në KFOR

KFOR-i ka rol të rëndësishëm në sigurinë dhe ruajtjen e paqes në rajonin e Ballkanit

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi më 3 qershor, një vizitë zyrtare në Komandën e KFOR-it, ku u prit nga komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Franco Federici. Gjeneralmajor Begaj shprehu mirënjohjen ndaj burrave dhe grave nën uniformë që shërbejnë në KFOR, ku edhe Shqipëria është pjesë e këtij misioni.

Nga ana e tij, gjeneralmajor Federici vlerësoi maksimalisht performancën e personelit ushtarak shqiptar që shërbejnë në KFOR. Në takim u vlerësua roli i KFOR-it si një ndër aktorët kyç në sigurinë dhe ruajtjen e paqes në rajonin e Ballkanit. Të dy liderët ushtarakë ndanë të njëjtat vlerësime dhe qasje mbi sfidat aktuale të sigurisë me të cilat përballet rajoni duke u fokusuar në impaktin e krijuar ndaj aktivitetit të forcave ushtarake nga kriza e pandemisë. Në përfundim të dy bashkëbiseduesit theksuan rolin e NATO-s në përballimin e sfidave si dhe forcimin e bashkëpunimit mes FARSH-it dhe KFOR-it edhe në të ardhmen.

Gjeneralmajor Begaj u takua edhe me personelin e FARSH-it që shërben në KFOR, ku u njoh me detyrat dhe përgjegjësitë e personelit të FARSH-it në këtë mision tepër të rëndësishëm dhe të vlerësuar nga NATO. SHSH-PFA i falënderoi ata për performancën, dedikimin dhe angazhimin



e tyre si ambasadorët më të mirë të Shqipërisë në këtë operacion shumëkombësh. Personeli i FARSH-it ka qenë vlerësuar me med-

aljen e NATO-s "Jo-Artikull 5", të dhënë nga sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për shërbimin e tyre në KFOR.

Stërvitja "Defender Europe 21"



Trupat tona në Kroaci: Përfundon stërvitja e zbulimit "Laufer-21"

Në kuadër të paketës së stërvitjeve "Defender-21", në periudhën 16-29 maj në Kroaci u zhvillua stërvitja ndërkombëtare e zbulimit "Laufer-21". Në këtë stërvitje Shqipëria u prezantua me një personel prej 11 ushtarakësh, efektivë të Kompanisë së Zbulimit të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS). Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte ndërveprueshmëria midis trupave të vendeve aleate, grumbullimi i informacionit duke përdorur disiplinat kryesore të zbulimit dhe zbatimi i ciklit të zbulimit. Trupat e Kompanisë së Zbulimit janë vlerësuar nga drejtuesit për performancën e lartë të treguar gjatë stërvitjes "Laufer-21". "Defender Europe 21" është stërvitja më e madhe ushtarake e zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipëria ishte vendi kryesor pritës.

Akademia e Forcave të Armatosura

Studentët e rinj ushtarakë do të pajisjen me dopio diplomë

"Fuqizimi dhe modernizimi i Akademisë së Forcave të Armatosura sipas modeleve më të mira amerikane dhe europiane, me fokus teknologjinë dhe cyber security është prioriteti më i rëndësishëm i Ministrisë së Mbrojtjes. Viti i ri akademik do të fillojë me disa bashkëpunime të rëndësishme të cilat do t'u mundësojnë studentëve të rinj pajisjen me dopio diplomë, pra bashkë me diplomimin ushtarak, ata do të kenë edhe një formim në një degë tjetër civile. Entuziast nga bashkëbisedimi që pata me brezin e parë të bachelorit pas rihapjes së kësaj akademie", shkruan Ministri Peleshi.



AMBASADORJA KIM PREZANTON PILOTEN SHQIPTARE

Teogerja e 2-të, Valdeta Mehanja, pjesë e ushtrisë amerikane

Stërvitja e armatosur e NATO-S "Defender Europe 21", prej më shumë se një muaji u zhvillua në Shqipëri. Në të, u angazhuan forca ushtarake nga shumë vende të botës, e një ndër ta, ishin edhe legjione të ushtrisë amerikane. Teogerja e 2-të, Valdeta Mehanja, shqiptare e Kosovës, e ka pasur për herë të parë vizitën në Shqipëri. Ajo është pilote në ushtri, dhe ngjyrat e Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara. Historinë e togeres shqiptare, e ka postuar në profilin zyrtar në "Facebook", Ambasada Amerikane në Tiranë, e cila, ka ilustruar edhe një deklaratë të saj. "Unë nuk e kisha vizituar kurrë Shqipërinë. Është një ndjenjë e jashtëzakonshme të jem këtu si pilote, në uniformë dhe me Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara. Unë nuk do ta kisha pasur kurrë këtë mundësi, për të fluturuar rreth Shqipërisë, nëse nuk do të ishte për ushtrinë.



Mundësia për ta përjetuar këtë, më bëri shumë të lumtur", është shprehur Mehanja.

Postimi i plotë i Ambasadës Amerikane: Nëse ka njeri që e njeh punën e palodhur dhe vendosmërinë, ajo është Toogerja e 2-të Valdeta Mehanja, pilote me Regjimentin e Aviacionit 1-131. Mehanja, shqiptare e lindur në Kosovë dhe shtetase amerikane, nuk e mendonte kurrë se

do mund të shihte Shqipërinë. "Unë nuk e kisha vizituar kurrë Shqipërinë më parë. Është një ndjenjë e jashtëzakonshme të jem këtu, si pilote, në uniformë dhe me Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara", tha ajo, "Unë nuk do t'a kisha patur kurrë këtë mundësi për të fluturuar rreth Shqipërisë nëse nuk do të ishte për Ushtrinë. Mundësia për t'a përjetuar këtë, më bëri shumë të lumtur".

Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë

Gjeneralmajor Begaj në Konferencën e 14-të të Shefave të Shtabit të Vendeve Ballkanike

Morën pjesë Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Serbia, Shqipëria dhe Turqia

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë në Konferencën e 14-të të Shefave të Shtabit të Vendeve Ballkanike (BCHOD) të organizuar në Sarajevë dhe Bosnje. Përveç delegacioneve nga nëntë vendet ballkanike anëtare të iniciativës, të ftuar në këtë takim ishin edhe shefat e Shtabit të Kroacisë dhe Sllovenisë, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, zëvendëskomandanti i Komandës së Bashkuar të NATO-s në Napoli, si dhe përfaqësues nga Komiteti Ushtarak i Bashkimit Europian.

Në konferencë u prezantuan dhe miratuan raportet vjetore të Grupit të Koordinimit, Nëngrupit të Punës mbi Kërcënimet Asimetrike dhe Nëngrupit të Punës së Edukimit, Trajnimit dhe Stërvitjes. Në përfundim të konferencës u nënshkrua një deklaratë e përbashkët nëpërmjet së cilës shefat e shtabeve

riafirmuan vendosmërinë e tyre për të forcuar bashkëpunimin midis Forcave të Armatosura.

Gjithashtu gjatë këtij aktiviteti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi takime të veçanta me homologët e Turqisë dhe Maqedonisë së Veriut, ku u diskutua mbi planet e bashkëpunimit dypalësh midis Forcave të Armatosura të vendeve respektive. Konferenca e shefave të Shtabit të Ballkanit është një iniciativë rajonale

vjetore me bazë rotacioni, e themeluar në vitin 2007 në të cilën marrin pjesë Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Serbia, Shqipëria dhe Turqia. Qëllimi kryesor i këtij forumi është rritja e bashkëpunimit ushtarak në të gjitha nivelet dhe përmirësimi i kapaciteteve të shteteve të rajonit në mënyrë që ata të mund t'iu përgjigjen respektivisht rreziqeve potenciale me natyrë asimetrike dhe krizave me origjinë jo-ushtarake.



NË KOPER, SLLOVENI

Dita e Vizitorëve të Shquar në stërvitjen "Adrion Livex-21"

Morën pjesë përfaqësues të lartë ushtarakë të forcave detare, sllovene, greke, italiane, kroate, të Malit të Zi dhe shqiptare

Në përfundim të stërvitjes Adrion Livex-21, stërvitje e zhvilluar nga data 29 maj deri më datë 7 qershor 2021, në Koper, Slloveni është zhvilluar dita e vizitorëve të shquar në të cilën morën pjesë përfaqësues të lartë ushtarakë të forcave detare, sllovene, greke, italiane, kroate, të Malit të Zi dhe ato shqiptare.

Në DVD mori pjesë komandanti i Flotiljes Detare kapiten i rangut të II-të Sabri Gjinollari. Në stërvitjen e zhvilluar në Koper Slloveni Forca Detare mori pjesë me anijen e klasit Iliria P-132 Oriku.

Gjatë zhvillimit të stërvitjes u trajtuan rëndësia mbi bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërmjet forcave detare të vendeve të rajonit që lagen nga deti Adriatik dhe Jon. Gjithashtu u diskutua mbi rëndësinë e vijimit të iniciativës



Adrion, për rritjen e sigurimit detar të rajonit, për forcimin dhe bashkëpunimin në kuadër të kryerjes së operacioneve të kërkim-shpëtimit në det. Të pranishmit i përshëndeti shefi i shtabit të Forcave të

Armatosura të Sllovenisë, komandanti i Njësisë Detare sllovene dhe më pas aktiviteti vijoi me një material prezantues për stërvitjen e zhvilluar nga forcat dhe mjetet pjesëmarrëse.

Stërvitja "Defender Europe-21"



Medalje në Kuçovë për ushtarakët amerikanë

Në Bazën Ajrore Kuçovë u zhvillua më 8 qershor, ceremonia e dhënies së medaljeve personelit ushtarak të Mbështetjes Logjistike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pjesëmarrës në Stërvitjen "Defender Europe-21". Në këtë ceremoni, të drejtuar nga nënkolonel Andrea Talbert, morën pjesë edhe komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë major Arqile Ollashi, zëvendëskomandanti i Bazës major Leandro Zyka dhe ushtarakë pjesëmarrës në stërvitje.

Në fjalën e saj të përshëndetjes, nënkolonel Talbert falënderoi trupat amerikane për kontributin e tyre në Stërvitjen "Defender Europe-21" si dhe gjithashtu adresoi një falënderim të veçantë për Komandën e Bazës Ajrore Kuçovë për mikpritjen dhe mbështetjen e tyre gjatë Stërvitjes "Defender Europe-21". Në fund, me një solemnitë u shpërndanë medaljet për personelin ushtarak amerikan.

Pilotët dhe helikopterët e Bazës Ajrore Farkë

Helikopteri "Cougar" shpëton dy turistët polakë, të bllokuar në Theth

Helikopteri "Cougar" me pilotin nënkolonel Agim Sallaku dhe ekuipazhin i tij kanë bërë të mundur transportimin në rrugë ajrore të turistëve polakë, e cila kishte pësuar dëmtime fizike nga vendi i quajtur "Maja e Alisë", në Theth për në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë. Gjatë fazës së përgatitjes për këtë mision ka qenë i pranishëm zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, ndërsa vetë misionin e ka ndjekur komandanti i Bazës Ajrore Farkë nënkolonel Julian Dulemata.

Gjithashtu helikopteri EC 135 me pilot Hamit Hoxha ka kryer misionin e ambulancës ajrore duke transportuar një të lënduar nga Spitali i Peshkopisë për në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë për një shërbim më të specializuar, bazuar në njoftimin e Qendrës Kombëtare të Urgjencave Mjekësore. Misionet janë mirë koordinuar nga Qendra e Kontroll-Raportimit, pasi janë përcaktuar saktë vendndodhjet dhe janë ndjekur deri në kryerjen me sukses të tyre.

BCU në stërvitjen “Defender Europe 21”

Ne ishim pjesë integrale e Civil Affairs të ushtrisë amerikane dhe Qendrës Shumëkombëshe të CIMIC (MNCC)

Kolonel **RAZIJE MEHMETI**
Drejtor i Bashkëpunimit
Civil-Ushtarak të SHPFA

ARBEN MOLLAJ
Specialist në Drejtorinë e
Bashkëpunimit Civil-Ushtarak të SHPFA

Stërvitja “Defender Europe 21”, është pa dyshim stërvitja shumëkombëshe më e madhe, e zhvilluar ndonjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në rajonin tonë, në tre dekadat e fundit, si për forcat pjesëmarrëse dhe mjetet e dislokuara, ashtu dhe për forcat dhe mjetet që do të kryenin kalimin transit në vendin tonë. Në vendin tonë pati disa zona stërvitjeje si Zall Herr, Rajoni i Bizës, Porti Detar Durrësit e ambientet e Forcës Detare, Rinas, Baza Ajrore Farkë, Baza Ajrore Kuçovë dhe Pashaliman Vlorë. Përmirësimi i ndërveprueshmërisë dhe rritja e besueshmërisë së aleatëve tek kapacitetet, përgatitja dhe procedurat e Republikës së Shqipërisë, për të operuar së bashku me forcat e vendeve të tjera të NATO-s apo edhe midis forcave të ndryshme ishin objektivat tonë operacionalë. Përfshirja e elementëve BCU/CIMIC gjatë stërvitjes për koordinimin me autoritetet dhe aktorët civilë (kryetarët e bashkive, njësi administrative, institucioneve qendrore e lokale dhe OJQ) që veprojnë në zonat e stërvitjes, përfshirja e të gjithë elementëve dhe projekteve të CIMIC/CA, ishin fokusi kryesor, në kuadër të mirë-koordinimit e planëzimit të detyrimeve të ndërsjella. Më konkretisht përmendim: Parapërgatitja e mjedisit civil si Gjeografia: Topografia; Klima; Popullsia; Resurset natyrore; Përbërja etnike; Përbërja fetare; Punësimi; Kultura; Arsimi; Infrastruktura; Transporti; Shërbimet publike; Shëndeti publik; Kushtet dhe mënyra e jetesës; etj.; Realizimi i fushatave të marketingut dhe botimet në shtypin ushtarak në funksion të impaktit dhe prezencës ushtarake për zhvillimin e stërvitjes. Realizimi i demonstrimit të strukturave ushtarake amerikano-shqiptare, nëpërmjet prezantimit të standave, pajisjeve e armatimit të forcës ushtarake, të vendosura në disa bashki si Durrës, Vlorë, Tiranë e Kuçovë; Realizimi i projekteve të CIMIC në interes të realizimit të projekteve të planifikuara të palës amerikane, si elementë i çështjeve humanitare, në zona të ndryshme të vendit; Koordinime dhe takime me autoritetet civile që ndodhen në zonat stërvitore: Mundësia e realizimit të takimeve koordinuese me disa nga organizmat ndërkombëtare në Tiranë (UNICEF, WFP, KKSH). Gjithashtu u planifikuan e realizuan takime koordinuese në Tiranë, Durrës, Kuçovë, Vlorë (kryetarët e bashkive, administratorët e njësi administrative të zonave ku do të jenë të dislokuara forcat ushtarake, si dhe përgjegjësit e agjencive turistike përkatëse (kjo për realizimin e ditëve kulturore). Agjenda e takimeve ishte në funksion të realizimit të projekteve të përbashkëta të CIMIC/IP, të realizimit të programeve kulturore me palën amerikane, përgjatë zhvillimit të stërvitjes. Gjithashtu, edhe për mundësitë e mbështetjes dhe vënien në dispozicion të dislokimit të kapaciteteve mbështetëse civile; Procedurat dhe politikat e Informimit Publik (Informimi Publik): Në kontekstin e koordinimit për çështjet e IP, u fokusua mbi qasjen e IP, mënyrat e realizimit të tij, duke pasur në konsideratë sigurimin e një mbështetjeje efektive të IP brenda zonës stërvitore, në mënyrë që të informohet audiencia dhe publiku i jashtëm dhe i brendshëm për stërvitjen; Procedurat e JVB: Për sa i përket realizimit të Ditës së Vizitorëve të Shquar (DVD Day), Ditëve të hapura (Open Day) dhe Ditës së Vëzhguesve (Observation Day), BCU/CIMIC bashkëpunoi ngushtë dhe koordinoi për organizimin dhe mbështetjen me strukturat e FARSH, ODC (Zyra e Bashkëpunimit Amerikan), degët e KKSH (Kryqi i Kuq Shqiptar) dhe bashkitë respektive.

Bazuar në doktrinën e BCU-së, manualin e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak, manualin e doktrinës e CIMIC të NATO-s, ngritja dhe funksionimi i strukturave të Bashkëpunimit Civil -Ushtarak (BCU/



CIMIC) në FA ka qenë prioritet i fushave të veprimit. Harmonizimi i proceseve strategjike, të planifikimit dhe objektivave në interes të stërvitjes ishin fokus i veprimtarisë së BCU, si një element i rëndësishëm për ndërveprimin civil-ushtarak. Kjo tregoi ndër të tjera, faktorët relevantë për një ndërveprim civil-ushtarak efektiv dhe efikas të angazhimeve tona, në kuadër të kësaj stërvitjeje, në qasjen gjithëpërfshirëse. Zhvillimi i aktivitetëve të BCU/CIMIC, duke prezantuar të gjitha parimet e nevojshme, që në fazat e planëzimit dhe kërkesat e trajnimit të personelit të CIMIC në bashkëpunim me Ekipet Civil Affairs të ushtrisë amerikane. Procesi i planifikimit që në takimet paraprake dhe konferencat planëzuese u fokusua në përfshirjen e BCU-së e në veçanti Detashmentit CIMIC të FA-së si një ndër strukturat kryesore të nivelit taktik. Në mënyrë të veçantë, faktorë të planëzimit dhe kërkesa të trajnimit të personelit të CIMIC, zhvillimi i aktivitetëve të CIMIC, mundësimi i ndërveprimit të përbashkët civil-ushtarak. Në interes të kësaj stërvitjeje në nëntor 2020, startoi takimi i përbashkët koordinues midis ekipit të CIMIC shqiptar dhe ekipit amerikan, me qëllim koordinimin e të gjithë veprimtarive civil-ushtarake gjatë periudhës së stërvitjes në interes të mbështetjes së stërvitjes me elementë të CIMIC/CA dhe Public Affairs (PA). Ekipi amerikan përbëhej nga kapiten Collen Cooper, PA Team Leader nga US Army, SFS Ethan Verzola, SSG Michael Lee, znj. Sabina Mitrovassili, ODC. Ekipi

shqiptar i CIMIC përbëhej nga kolonel Raziqe Mehmeti, drejtor i J9, n/kolonel Alda Sula, oficer shtabi J9, major Orges Baholli, specialist CIMIC J9, n/kolonel Ylli Bajo, shefi Detashmentit CIMIC, z. Arben Mollaj, koordinator nga J9. Fokusi kryesor në këtë takim ishte njohja me strukturën aktuale të BCU-së në FA, si dhe mundësinë e përfshirjes së elementëve dhe projekteve të BCU-së gjatë stërvitjes, si dhe koordinimi me autoritetet dhe aktorët civilë (kryetarët e bashkive, komunave, OJQ, ON) që veprojnë në zonat e stërvitjes, politikat e Informimit Publik, në kuadër të mirë-koordinimit e planëzimit të detyrimeve të ndërsjella, sipas fushave, Parapërgatitja e mjedisit civil; Koordinim dhe takime me autoritetet civile; Realizimi i aktivitetëve; Ngritja e Qendrës Shumëkombëshe të BCU-(MNCC); Ngritja e Zyrës së Informimit Publik; Ngritja e CIMIC/CA në mbështetje të ekipeve të përbashkëta shqiptaro-amerikane, në Tiranë, Durrës, Vlorë e Kuçovë; Aktivizimi i BCU-së shqiptare në të gjitha rajonet ku ka prezencë të strukturave ushtarake, në varësi të detyrave të CIMIC/Public Affairs.

Ky grup pune i përbashkët, kishte për qëllim koordinimin për realizimin e fushatave marketing në funksion të impaktit dhe prezencës ushtarake për zhvillimin e stërvitjes Durrës-Vlorë-Kuçovë-Tiranë. Zhvillimi i Ditës së Vizitorëve të Shquar të kësaj stërvitjeje ishte dita e hapjes së kësaj

stërvitjeje me pjesëmarrjen e personave VIP e të ftuar nga vendi ynë, përfaqësitë ushtarake dhe autoritete civile të ndryshme. Për zhvillimin e fushatave marketing ku ka prezencën e strukturave ushtarake të përbashkëta, me angazhimin e përfshirjen e strukturave operacionale të FA-së, SHBA-së, bashkive dhe KKSH, duke qenë pjesë ekspozimi i një pjese të pajisjeve dhe armatimit të forcës ushtarake. Në zbatim të kësaj ekipi i përbashkët realizoi takime me përfaqësues të pushtetit vendor, OJQ, në interes të stërvitjes “Defender Europe 21”, me qëllim koordinimin e të gjithë veprimtarive civil-ushtarake gjatë periudhës së stërvitjes, në interes të mbështetjes së saj me elementë të CIMIC, Public Affairs dhe aktivitetëve kulturore.

CIMIC/CA pjesë e trajnimeve, për mbështetjen e vendit pritës (HNS)

CIMIC/CA ishte pjesë e trajnimeve, kryesisht për mbështetjen e vendit pritës (HNS), për të cilën u arrit bashkëpunimi e koordinimi i pjesëmarrjes nga strukturat shtetërore nën kuadër të Vendit Pritës, si pushteti lokal, policia e rendit, policia



kufitare, doganat, portet e aeroportet, shëndetësia, autoritete mjedisore, etj. CIMIC paraqiti informacion mbi infrastrukturën civile dhe shërbimet publike. Kjo përfshinte kapacitetet dhe kufizimet dhe mund të ndryshonte me kalimin e kohës si rezultat i lëvizjes së trupave apo mjeteve nga Porti Detar Durrës apo pikat hyrëse kufitare në rajonin e dislokimit. Ky aktivitet kishte për

qëllim njohjen me mënyrën dhe organizimin e operacioneve logjistike (JLOTS), si dhe koordinimin nga strukturat e shtetit shqiptar, për përcaktimin dhe identifikimin e kërkesave për planëzimin, koordinimin dhe zhvillimin e procesit të hyrjes, shoqërimin, dislokimit, stërvitjes, si dhe kthimin nga pikat e hyrjes kufitare (tokësore, ajrore e detare). Në interes të stërvitjes e në kuadrin e bashkëpunimit ushtarak dhe partneritetit me SHBA-në, në datat 15–25 shkurt 2021 u zhvillua një trajnim me personelin e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak në FA të përzgjedhur në interes të stërvitjes “Defender Europe 21”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte aftësimi i mëtejshëm i personelit që aktualisht punon në strukturat e BCU-së (veçanërisht Detashmentit të CIMIC), si dhe personelit të përzgjedhur nga strukturat e FA-së, si një element kyç në mbështetje të operacioneve civil-ushtarake në bashkëpunim me palën amerikane, për të gjithë diapazonin e operacioneve brenda dhe jashtë vendit. Ekipi amerikan i përbërë nga 3 kapitenë, kapiten Pavel Ruben, kapiten Jose Melendez, kapiten Douglas Brown. Ndërsa ekipi shqiptar mori pjesë në këtë trajnim me 25 vetë. Ushtarakët e Ushtrisë Amerikane të Brigada 361 e Çështjeve Civile, USAREUR, bashkëpunuan me profesionistë të Bashkëpunimit Civil Ushtarak të Shqipërisë (CIMIC) nga të gjitha strukturat e FARSH për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprimin ushtarak të SHBA-së, me ushtarakët shqiptarë në tokën shqiptare, me fokus rritjen e aftësive ndërvepruese mes strukturave ushtarake dhe autoriteteve civile në rajonet e dislokimit e veprimit të trupave ushtarake amerikane.

Në javën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet në marrjen e njohurive kryesore të punës në BCU, Familjarizimi me CIMIC në NATO; Planëzimi i CIMIC-ut; Puna e CIMIC-ut në nivel taktik; Ndërlidhja e CIMIC në NATO; Angazhimet e CIMIC-ut; Angazhimi kryesor i udhëheqësit (KLE)/Ndërlidhja dhe arkitektura e CIMIC-ut;

Strategjia e angazhimeve; Zhvillimi i një kuptimi më të thelluar të mjedisit civil, si dhe studimi i zonës. Krahas pjesës teorike për dhënien e njohurive bazë në këtë fushë çdo ditë prezantimet qartësoheshin duke kaluar në veprime konkrete praktike (punë në grup). Pjesëmarrësit u njohën dhe vepruan konkretisht me mënyrën e veprimit në raste të dhënies së informa-



cionit ndaj gazetarëve e reporterëve (tek mënyrat dhe rrugët e dhënies së tij). Me rëndësi të veçantë u trajtua roli dhe vendi që BCU-ja luan në mjedisin e operacioneve shumëkombëshe të udhëhequra nga NATO.

Java e dytë e trajnimit filloi në Komandën e Forcës Detare, ku pjesëmarrësit u familjarizuan mbi rajonin e vendosjes së trupave amerikane, ambientet që do të përdorin, si dhe operacionin logjistik në bregdet. Më pas takimi vijoi me autoritetet portuale, ku pjesëmarrësit u ndanë me grupe pune, Grupi Strategjik, Grupi Operacional dhe Grupi taktik e vijuan në njohjen e familjarizimin me ambientet e Portit Detar Durrës (PPD). Autoriteti Portual Durrës (APD) na siguroi mbështetje në mbarëvajtjen e aktivitetit në kuadër të stërvitjes "Defender Europe 21", duke vendosur në dispozicion ambientet e nevojshme, për t'u përdorur për realizimin e takimeve koordinative. U realizuan praktikisht aktivitete mbi takimet me përfaqësues nga APD (siguria e logjistika), Bashkia (institucioni dhe Emergjencat Civile), Policia (Policia Rendit dhe Policia Kufitare), Autoriteti Mjedisor (QNOD dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit Durrës), Dogana (Dogana e Portit Durrës dhe Agjencitë private të çdoganimeve), Shëndetësia (Spitali Durrës dhe Drejtoria e Shëndetit Publik Durrës), etj. Pjesëmarrësit u njohën gjërsisht me radhën e punës, aktivitetin dhe dokumentet e nevojshme që i nevojiten një oficeri të BCU-së për tu familjarizuar dhe vepruar aktivisht në role të ndryshme të funksioneve të BCU-së.

Duke përdorur konceptet "Defender Europe 21", Angazhimet Kryesore të Udhëheqësit (KLE), kryerja e trajnimit të përbashkët të KLE (Key Leader Engagement) me ekipet shqiptare CIMIC, ishte ndihmesë në realizimin e kësaj stërvitjeje dhe zhvillimin e ndërveprimit më të madh gjatë përgatitjes për operacionet Defender Europe 21. Trajnimi, gjithashtu u ofroi ekipeve shqiptare CIMIC një mundësi për të mësuar në lidhje me Qendrën Shumëkombëshe CIMIC (MNCC) që do të veprojë në Shqipëri për Defender Europe 21. Individët nga ekipet shqiptare CIMIC do të marrin pjesë në MNCC së bashku me përfaqësuesit e Çështjeve Civile nga Brigada 361 dhe ekipe të tjera të CIMIC-ut NATO-s. Një mundësi e shkëlqyer e ushtarakëve amerikanë dhe shqiptarë iu ofrua për të zhvilluar marrëdhënie më të ngushta kulturore dhe mirëkuptim të përbashkët, pasi kjo është hera e parë pas shumë vitesh që forcat amerikane kanë punuar ngushtë me ushtrinë shqiptare dhe hera e parë për një bashkim kaq të madh një lloj operacioni të përbashkët si "Defender Europe 21".

Plani i koordinimit me strukturat e qeverisjes vendore e lokale

Në muajin prill 2021, në interes të stërvitjes, një ekip Amerikan (Civil Affairs Team) së bashku me ekipin e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak (BCU) i FA-së (AL CIMIC), realizuan një plan koordinimi me strukturat e qeverisjes vendore e lokale, me qëllim realizimin e takimeve dhe koordinimin me udhëheqësit kryesor në nivel bashkie, angazhimi i tyre, si dhe ndikimet e mundshme në jetën e përditshme gjatë periudhës stërvitore, në interes të mbështetjes së saj me elementë të bashkëpunimit, çështjeve civile dhe aktiviteteve promovuese. Këto takime kishin si objekt: Rritjen e nivelit të bashkëpunimit reciprok në interes të përmbushjes së misionit të forcave ushtarake shqiptaro-amerikane; Krijimin e lidhjeve dhe vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet strukturave të FA-së dhe autoriteteve civile në zonën e dislokimit dhe në rajonet e kryerjes së detyrave dhe stërvitjeve; Bashkëpunimin dhe mbështetjen e CIMIC-ut shqiptar e amerikan me strukturat e qeverisjes qendrore dhe lokale, për kryerjen e aktiviteteve CIMIC, sipas rajoneve të dislokimit; Përcaktimin e zonave të mbrojtura (bimët, zogjtë, ndërtesat historike, vendet kulturore, etj.), për të cilat duhet të jemi të vetëdijshëm, të shmangim etj.

Realizimi i këtij plani koordinimi u vlerësua si nga pala amerikane. Ekipi i përbashkët shqiptaro-amerikan, me përfaqësues nga BCU-të e komandave kryesore, përfaqësues së Komandës Amerikane në Europë (CA Team), si dhe përfaqësues të Detashmentit CIMIC, realizuan takime të cilat kishin në fokus impaktin e strukturave ushtarake në rajone të ndryshme, realizimin e koordinimit sa më efektiv me autoritetet civile dhe strukturat përgjegjëse gjatë stërvitjes, si dhe realizimin e ditëve të hapura (Open Day) në nivel bashkie.

Ekipi amerikan në këtë takim përbëhej nga: Major Grady Robinson, ODC; Kapiten Warner, Paul, USARMY 21 TSC; K/kapter Brooks R Yundt, USA; shoqëruar nga znj. Sabina Mitrovassili ODC. Në Ekipin shqiptar morën pjesë, kolonel Razije Mehmeti, n/kolonel Hatixhe Kola, n/kolonel Ylli Bajo, n/kolonel Dritan Sopaj dhe z. Arben Mollaj. Pas organizimit për detyrë të BCU-së në FARSH, me përfshirjen e elementëve BCU gjatë stërvitjes, u vijua për bashkëpunimin e koordinimin me autoritetet dhe aktorët civilë (kryetarët e bashkive, komunave, OJQ, ON) që veprojnë në zonat e stërvitjes, përfshirja e të gjithë elementëve dhe projekteve të BCU-së dhe politikave e Informimit Publik, në kuadër të mirë-koordinimit e planëzimit

të detyrimeve të ndërsjella, sipas fushave të Parapërgatitjes së mjedisit civil; Koordinim dhe takime me autoritetet civile; Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta; Ngritja e Qendrës BCU-Multinational CIMIC Center; Ngritja e Zyrës së Informimit Publik; Aktivizimi i BCU-së shqiptare në varësi të detyrave të CIMIC/CA.

Në të gjitha bashkitë, pas prezantimit të aktiviteteve të ekipit shqiptaro-amerikan, drejtuesit e bashkive u informuan për detajet e operacioneve stërvitore që do të ndikonin ose mund të ndikonin në jetën e përditshme të civilëve. Kjo përgatiti më mirë popullsinë civile për fluksin e personelit ushtarak dhe lëvizjet në jetën e përditshme, përmirësoi marrëdhëniet civil-ushtarake. U vlerësua angazhimi dhe pjesëmarrja e bashkive, duke u dakordësuar në parim mbi aktivitetet e përbashkëta të forcës ushtarake (shqiptaro-amerikane) dhe Autoritetet Civile. Bazuar



në procedurat dhe kërkesat për realizimin e aktiviteteve, duke vlerësuar propozimet e tyre, pas trajnimit 2-javor u dakordësua për Përcaktimi i ekipit CIMIC (prej 4 vetash), si pjesë e MNCC pjesëmarrës në stërvitje, në Pashaliman; Caktimin e ekipeve të CIMIC-ut në Tiranë, Durrës, Ekipi i Kuçovë dhe Vlorë, të cilët do të veprojnë bashkë me ekipet amerikane, CA Team; Caktimi i elementëve të BCU-së, në Zall Herr, Bizë, Rinas, Farkë, Kuçovë, Porti Detar Durrës, Pashaliman; Pjesëmarrje dhe mbështetje të aktiviteteve tek mjedisi civil, nëpërmjet realizimit të fushatave marketingut në funksion të impaktit dhe prezencës tyre në zonat përreth rajoneve ushtarake për zhvillimin e stërvitjes; Vijimi i koordinimit sa më efikas në interes të stërvitjes me të gjithë institucionet e përfshira në stërvitje si dhe pushtetin vendor; Koordinim dhe dhënie të asistencës humanitare (HA) tek institucionet, bashkitë, shkollat për realizimin e projekteve të BCU-së.

MNCC-Qendra Shumëkombëshe e Koordinimit CIMIC

Për herë të parë u ngrit në Shqipëri MNCC me pjesëmarrës nga shtete të ndryshme, në stërvitjen Defender 21, ku ambasadorja amerikane znj. Yuri Kim, vlerësoi këtë aktivitet të Bashkëpunimit Civil-Ushtarak, për të ndarë gjetjet e duhura ndërsa kryen angazhime civile për stërvitje të përbashkëta, kryesisht në kuadër të bashkëpunimit të suksesshëm të strukturave ushtarake me organet e pushtetit qendror në bashkitë Tiranë, Durrës, Vlorë e Kuçovë. Një vlerësim të veçantë pati dhe nga gjeneral brigade Wanda N. Williams,

Komandante e Misionit të 7-të Mbështetës për angazhimin dhe punën e bërë nga ekipet e CIMIC koordinimin dhe bashkëpunimin me autoritetet civile në rajonet ku ishin të dislokuara trupat. Ekipet e çështjeve civile dhe angazhimet civile zhvilluan një seri takimesh koordinative me drejtuesit e pushtetit lokal, policia e rendit, policia kufitare, doganat, emergjencat civile, zjarrfikësit, portet e aeroportet, shëndetësia, autoritete mjedisore, etj., për të komunikuar në lidhje me çështje të tilla si rrugët e lëvizjes, shmangien e problemeve për popullsinë civile dhe rritjen e pranisë ushtarake në zonë gjatë gjithë ushtrimit (impaktin në pjesën civile). Kol. Gorbea, vlerësoi punën krahas për krahas me aleatët tanë BCU (CIMIC) të vendit pritës, gjë që e bëri më të efektshëm të gjithë koordinimin me MNCC. Praktikata e punës që startuan me rikonicion në Pashaliman, për të parë vend-dislokimin, si dhe mundësitë e uljes së helikopterit për raste emergjente; video-telekonferenca me komandantin e Brigadës 361 për CA të USAREUR, ku u diskutua për nevojën e bashkëpunimit dhe prirjen e njësisë Multinacionale CIMIC (MNCC); përcaktimi i ambienteve që MNCC përdori në funksion të stërvitjes; sistemimi, pritja, akomodimi ishin pjesë e planeve, duke u vëzhguar nga n/kol Larson, shefi MNCC. Gjatë vizitës nga komandanti i Brigadës 361 Civil Affairs, kolonel Carlos Gorbea dhe kolonel Razije Mehmeti në MNCC, u njohën me ambientet e Qendrës Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Civil-Ushtarak/MNCC, procedurat në koordinimin me institucionet qendrore dhe vendore dhe realizimin e takimeve nëpërmjet grupeve CIMIC të ndërthurura ndërkombëtare, në kuadër të DE21. Kolonel R. Mehmeti vlerësoi e falënderoi pjesëmarrësit për koordinimin me auto-

Qendra Ndërkombëtare e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak/MNCC (Multinational CIMIC Center) në Pashaliman, Vlorë zhvilloi një seance dhurimi gjaku për fëmijët talasemikë dhe komunitetin në nevojë. Nga vendet donatore u dalluan Rumania, USA dhe ushtarakët e Flotiljes Detare Pashaliman. Pas përfundimit të operacioneve një gjë u vu re nga MNCC, të cilët kërkonin feedback me autoritetet e ndryshme. Kryetarët e bashkive Durrës, Vlorë, Kuçovë, N/kryetari i bashkisë Tiranë, Ministria e Shëndetësisë, Emergjencat Civile, Shërbimi Zjarrfikës, në takime me përfaqësues të ushtrisë së SHBA-së që ndodhën në Shqipëri në kuadër të stërvitjes "Defender Europe 21", shprehën mirënjohje në marrëdhëniet e shkëlqyer midis Shqipërisë dhe SHBA-së. Zhvillimi i kësaj stërvitjeje të trupave amerikane në Shqipëri ishte e një rëndësie të lartë jo vetëm për përmasat, por edhe për mesazhet e sigurisë që përcjell. Po kështu takimi me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Ardi Veliu, i cili falënderoi ushtarakët amerikanë dhe Shtetet e Bashkuara që zgjidhën Shqipërinë si një ndër vendet që mirëpret këtë stërvitje dhe se kjo është dëshmi e qartë e mbështetjes së SHBA-së për Shqipërinë.

Ajo që u arrit dhe eksperiencia e veçantë

Si përfundim mund të themi se bashkëpunimi i suksesshëm i strukturave ushtarake me organet e pushtetit qendror në të gjitha rajonet stërvitore ku ka pasur dislokim apo lëvizje trupash tashmë është kthyer në një traditë me vlera, e cila duhet të merret shembull edhe për drejtime të tjera të punës sonë. Të gjithë jemi dëshmitarë të stërvitjeve të mëdha në det dhe në tokë,

brenda e jashtë vendit, të cilat një pjesë të suksessit të tyre ia dedikojnë edhe bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet strukturave ushtarake dhe drejtuesve të pushtetit qendror e lokal. CIMIC i FARSH në përmbushje të detyrave që rrjedhin nga misioni, në fokus të kontaktit me përfaqësuesit e pushtetit qendror e lokal, organizatat jo qeveritare, mediat (elektronike dhe të shkruara) për rritjen e nivelit të bashkëpunimit reciprok në interes të përmbushjes së misionit të Forcave të Armatosura. Nëpërmjet këtyre takimeve

bëhet i mundur vlerësimi i kërkesave dhe nevojave reale të autoriteteve civile, si dhe do të mundësohet bashkëpunimi real dhe i frytshëm për t'i paraprirë në kohë dhe në cilësinë e duhur aktiviteteve të përbashkëta. U arrit integrimi dhe koordinimi për aktivitetin e përbashkët nga të gjithë pjesëmarrësit ndërkombëtarë, duke u familjarizuar e vepruar në mënyrë unike për realizimin e vetë misionit të MNCC. Kontribut tepër i veçantë e mbresëlënës i MNCC ishte humanizmi (dhurimi i gjakut në mënyrë vullnetare për fëmijët talasemikë e komunitetin në nevojë në Shqipëri). Qendra Ndërkombëtare e CIMIC në Shqipëri ku vendi ynë ishte HN, ishte një eksperiencë e veçantë e tepër e rëndësishme në mbështetje të stërvitjes "Defender Europe 21" nën moton "World Class Warriors" ku ekipet CIMIC të përbërë nga ushtarakë të kombësive të ndryshme të vendeve partnere, punuan e bashkëvepruan në mënyrë të suksesshme në një periudhë kohore relativisht të shkurtër.

Në përfundim të të gjithë këtyre takimeve intensive drejtuesit e organeve të pushtetit vendor vlerësohet kontributi i strukturave ushtarake në ndihmë të komunitetit, si një ndër mundësitë më të mëdha dhe më të organizuar për këtë qëllim. Ata kërkuar dhe shprehën domosdoshmërinë e përfshirjes së strukturave ushtarake në projektet e ardhshme, duke veçuar sidomos ndihmesën që ato mund të japin në zgjidhjen e problematikave të tilla si, për rihapjen e rrugëve të bllokuara, rikonstruksionin e urave, shkollave apo çerdheve të dëmtuara nga moti i keq apo fatkeqësitë e tjera natyrore në këto zona etj. gjatë situatave të paparashikuara nga ana e tyre.



Ushtarakët tanë në fushën e publicistikës

Shpendi Topollaj, një jetë duke shkruar...



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Romani që bën apel për pajtim

Ish ushtaraku Shpend Hulësi Topollaj ka dalë para lexuesit me romanin "Pajtimi", një vepër pranë realitetit të sotëm në Shqipëri. Romani na vjen në një kohë kur pas një periudhe tridhjetëvjeçare ende vazhdon përplasja klasore mes forcave politike. Në këtë vepër shfaqet ajo shtresë shoqërore që vuajt në sistemin e kaluar. Vet romani "Pajtimi" është një apel për kohën që autori, gjatë gjithë trajtimit të subjektit bën thirrje për këtë domosdoshmëri shoqërore dhe politike. Autori shtjellon përmes një subjekti i cili rrjedh natyrshëm, vijnë ngjarje në detaje dhe në fund apeli i autorit për ta lënë pas të kaluarën, por të mos e harrojmë, për integrimin e vendit në familjen europiane. Autori e ka ndërthurur këtë mision në veprën e tij nëpërmjet të besuarve të mendimit intelektual, të cilët ishin të dy pjesëmarrës në të kaluarën e përbashkët. Personazhet kryesorë me qëndrime dhe bindje të ndryshme politike, përsëri bashkëjetojnë në të sotmen. Në roman ka ndodhi dhe degëzime, fenomene, ngjarje dhe personazhe, boshti i romanit ndërtohet nga veprimtaria e dy personazheve kryesore, Jakov S dhe Bedri B të dy këta personazhe janë njerëz të letrave, por kanë qëndrime të ndryshme. Jakov S ndikoi në burgosjen e Bedri B. Ky pas burgut dhe përmbyesjes së regjimit, nuk ngurron të botojë shkrime ndaj Jakov S.

Shpend Topollaj në roman për t'i dhënë fund luftës së tyre, që ka bërë për vite me radhë, jep çelësin në një rreth të njerëzore. Nga një ftohtësi midis dy personazheve, na vjen një ngrohtësi dhe lirizëm, pasi vjen një kohë dashurie midis djalit të Jakov S dhe vajzës së Bedri B. Dashurinë mes dy të rinjve, autori e ka përshkruar bukur dhe i ka dhënë ftohtësisë, dashuri dhe e përkrah dashurinë e tyre si simbol të bashkimit dhe të pajtimit. Kjo dashuri mes të rinjve, pa u ndikuar nga e kaluara e prindërve të tyre, na jep një të ardhme për një angazhim të përbashkët. Kështu dy të rinjtë dalin si garant për unitet, larg bindjeve politike. Autori në roman shtjellon dhe linja të tjera nga realiteti ynë aktual. Në roman trajtohen probleme aktuale si korrupsioni, i cili shfaqet përmes ndërtimit të një hoteli me para të pista, përfshirjen e deputeti N, fenomene si matrapazllëku dhe manipulimet etj.

Fenomeni që brenda familjeve, për të qenë të siguarur në çdo qeverisje, dy vëllezër bëhen anëtar partie kundërshtarë njëri me tjetrin. Autori përmes takimeve të ndryshme, bisedave dhe dialogëve të shpeshtë, nuk ka nguruar të shprehet hapur për shumë probleme të kohës, por dhe të tërheqë vëmendje për të mos u përsëritur dukuritë negative të regjimit të kaluar. Në roman autori ka përshkruar mjaft skena që të ngelen gjatë në mendje, si veprimi i kryetarit të degës së brendshme, përpjekjet për të rekrutuar mësuesin Hajdar Sh, tortura në burgje, dëbimi dhe internimi i familjes së Kristaqit etj. Autori ka ditur që me mjeshtëri të ngrihet në lartësinë e gjykimit dhe me këta njerëz, që provuan dhunën në diktaturë, të gjejë forca për të falur, për t'i çuar drejt bashkimit dhe aktit të madh të pajtimit. Ky është një apel që përshkruan tërë romanin e shkrimtarit Shpend Topollaj.



Njohje me Shpendi Hulësi Topollaj

Shpendi Hulësi Topollaj ka lindur më 14 shkurt 1947 në Berat. Babai i tij, Hulësiu, ka qenë partizan nga të parët, e më pas officer, jurist dhe shkrimtar. Ai ishte nga Novosela e Kolonjës, kurse nëna, Hatijeja, ishte nga fisi i degjuar për atdhetari i Agallinjve në Vlorë. Fëmijërinë dhe rininë e ka kaluar në Shkodër dhe Tiranë. Me përfundimin e shkollës 7-vjeçare "Misto Mame", në Tiranë nis studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej", të cilën e mbaron në vitin 1964. Më tej vazhdon Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe në vitin 1966 titullohet officer këmbësorie. Emërohet në repartet ushtarake të Durrësit, ku ka kryer detyra të ndryshme si: instruktor i stërvitjes me universitarë, shef i stërvitjes në Brigadën e Katërt të Mbrojtjes Bregdetare, komandant batalioni etj.

Kur babai u godit si bashkëpunëtor i "grupit puçist", me argumentin se kishte shkruar 10 vjet më parë një libër për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, dhe ku midis të tjerave lartësonte figurën e Heroit të Popullit, Petrit Dume dhe të tjerë të luftës nga Kolonja, ulet në detyrë të ulët, dhe punon në një repart ushtarak të largët, ku qëndron për rreth njëzet vjet. Por, Shpendi me formimin i tij intelektual, me edukatën e marrë nga familja dhe me përkushtimin në detyrë, shquhet për rezultate shumë të larta. Në punën e tij ai ka shfaqur si kuadro talent, kulturë, guxim, ndershmëri dhe shpirt krijues duke realizuar të gjitha detyrat ushtarake. Në gjithë veprimtarinë dhe punën e tij ka gëzuar respektin e shokëve dhe vartësve të tij, oficerë dhe ushtarë. Më këmbëngulje kryen studimet në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike. Ai studion me pasion, artin ushtarak, fushën e letërsisë, artit dhe të historisë etj. Me gjithë vështirësitë, Shpendi Topollaj ishte nga kuadrot e parë të ushtrisë që mbështeti proceset demokratike në vend, duke shfaqur kurdoherë mirëkuptim.

Në këtë kohë i jepet grada ushtarake nënkolonel dhe caktohet me punë shef i Mbrojtjes Civile të rrethit të Durrësit. Me përfundimin e karrierës ushtarake, caktohet në detyrën e Shefit të Seksionit të Mbrojtjes Shoqërore në Këshillin e rrethit të Durrësit.


Shpendi, promotor i organizimit të veprimtarive

Në jetën shoqërore ai bëhet promotor i organizimit dhe zhvillimit të mjaft veprimtarive, kushtuar figurave të shquara, promovim të krijimtarisë letrare të autorëve të ndryshëm durrsakë. Këto veprimtari kanë qenë mbresëlënëse dhe kanë gjetur pasqyrim në stacionet televizive, në radio dhe gazeta. Më tej ai punon në Gjykatën e Rrethit, si jurist për 7 vite me radhë, si dhe për 12 vite ka kryer detyrën e Përmbaruesit gjyqësor, ku dhe doli në pension. Gjatë tërë veprimtarisë së tij ka kryer detyra shoqërore, si anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në Durrës, nënkryetar i Shoqatës Kombëtare "Skënderbegasi", kryetar i degës së kësaj shoqate në Durrës, anëtar i Kryesisë së shoqatës të miqësisë Shqipëri - Rusi, nënkryetar i degës së SHKUR-it, sekretar i shoqatës të Intelektualëve në Durrës, anëtar i Këshillit Kombëtar të OBVL, nën kryetar i Shoqatës Kolonja, dega Durrës etj. Kohët e fundit është zgjedhur kryetar i Bordit drejtues të teatrit "A. Moisiu", është shpallur "Ambasador për Paqen", i është dhënë titulli "Noble Peace Personality Award" nga World Parliament For Peace dhe njëkohësisht është zgjedhur nënkryetar i Federatës së Paqes Universale dega Durrës.

Pas viteve '90 të shek. XX fillon të shkruajë dhe të botojë krijimtari të mirëfilltë letrare, thuhet në të gjitha zhanret e letërsisë, si poezi, tregime, novela,

romane, publicistikë, kritikë letrare, drama etj., dhe mjaft artikuj të shkruar e botuar në shtypin e kohës. Disa nga librat dhe krijimet e tij janë përkthyer në gjuhë të huaja dhe botuar jashtë vendit duke u vlerësuar nga kritika e specializuar dhe lexuesit. Në nëntor 2015 nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Rusisë i është dhënë çmimi "Pushkin" me motivacionin "Për bukurinë e fjalës dhe të mendimit". Ndërsa për krijimtarinë e tij, janë botuar librat "Të shkruash në liri - Shpendi Topollaj: poeti, prozatori, kritiku, njeriu", "Liria e të shkruarit" dhe "Kur bashkohet mendja me zemrën". Nga mjaft studiues është vlerësuar për cilësitë e tij të rralla artistike, tematikën e zgjedhur dhe mesazhet që përcjell, nga penë të njohura. Në librin "Ishte koha kur...", kritiku Kostaq Xoxa ka shkruar: "Autor i palodhur dhe i talentuar i letrave shqipe të kohës së pas-diktaturës, Shpendi Topollaj, të befason me prodhimtarinë e tij aq të shumëllojshme në gjinitë letrare më të larmishme: në poezi, në tregime, në novelat, dhe në romanet e tij; në kritikën letrare, në zbulimin, e thesareve të lashtësisë dhe veçanërisht të mitologjisë greke; në reportazhin artistik, në pasqyrimin dhe portretizimin e figurave të nëpërkëmbura nga një sistem totalitar gjysmëshekullor...".

Në vepra ka frymë njerëzore



Krijimtaria e tij është e gjithanshme, ka vëllime me tregime e novela, libra me poezi, romane, përmbledhje me kritika letrare, monografi, artikuj të panumërt nëpër faqet e shtypit etj. Ka botuar këto libra: "Lirikat e zemrës", poezi, përkthyer në italisht (1996); "Gjithë dashuritë e mia", poezi (1996); "Akropol për të gjithë", poezi, përkthyer në greqisht (2000); "Mjaft u grindën Perënditë", poezi (2001); "Tekat e Perëndive", poezi (2004); "Magjistari i dashurisë", poezi (2004); "Kumtë nga Olimpi", poezi

(2009); "Ishte koha kur...", poezi epigramik (2011); "Metaforë malli", poezi me bashkautorë (2013); "Perla më e bukur", poezi (2014); "Ironia e moshës", poezi të zgjedhura (2015); "Rrëfimi i Kapitenit", tregime, përkthyer në frëngjisht (1998); "Një njeri i çuditshëm", tregime (2007); "Fisniku dhe horri", tregime dhe novela (2008); "Autografi", tregime (2011); "Arratisja", tregime (2011); "Amaneti", tregime, përkthyer në rumanisht (2014); "Adulteri", tregime (2012); "Allamanet", novelë, (përkthyer në italisht dhe gjermanisht (2008); "Pushkatimi", novelë, përkthyer në italisht dhe rusisht (2008); "Ahu në mes të pyllit", tregime e novela të zgjedhura (2015); "Mobiliet e vjetra", tregime, përkthyer në rusisht (2019); "Kurva", novelë, përkthyer në rusisht (2012); "Lotët e zambakut", roman, përkthyer në rusisht (1998); "Mashtruesi", roman (2006); "Mallkimi", roman (2010); "Luani i kafazit", roman (2011); "Zhgënjimi i partizanit të Gramozit", roman (2011); "Unë kam qenë në Mat'hauzen", roman (2013); "Biri i Golemit, Adem Meta", roman (2015); "Jetoj në kujtimet tuaja", monografi (2016); "Romancë me letra dashurie", roman (2018); "Pajtimi", roman (2021); "E përdala", dramë (2020); "Ata ishin njerëz", dramë (2020); "Flakët e fjalës", kritika letrare (1998); "Jemi vëllezër", kritika letrare (2000); "Shoku më i mirë", kritika letrare (2002); "Paqja-virtyt i civilizimit", kritika letrare (2003); "Triumfi i arsyes", kritika letrare (2004); "Porta e dijes", kritika letrare (2007); "Vepra dhe vlera", kritika letrare (2008); "Armiq pa dashje", kritika letrare (2009); "Vagoni i mallrave", kritika letrare (2011); "Homazh librave", kritika letrare (2012); "Libri si Papyrus", kritika letrare (2013); "Kur qesh dhe qan Kadare", kritika letrare (2013); "Vargmali i letrave", kritika letrare (2014); "Stile dhe Lapsa", kritika letrare (2014); "Po thahet shpirti", kritika letrare (2016); "Shkolla ime "Skënderbej", kritika letrare (2017); "Urat e librave", kritika letrare (2017); "Purgatori i librave", kritika letrare (2018); "Flas për ju", kritika letrare (2019); "Jehona e librave", kritika letrare (2019); "Ese rreth shprehjeve mitologjike", (2019); "Dantja... e të tjerë", kritika letrare (2020); "Shenjtorët e letrave", kritika letrare (2020); "Alternativa e kritikës", kritika letrare (2020); "Pesha e dinjitetit", kritika letrare (2020) dhe "Pranë jush", kritika letrare (2021).

Talenti i tij ka spikatur në çdo libër, në çdo gjini duke e bërë atë tanimë një nga autorët tanë më të njohur dhe të dashur për lexuesit shqiptarë dhe me gjerë, sepse shumë prej tyre janë përkthyer dhe në disa gjuhë të huaja. Të shumtë janë autorët dhe krijuesit që ndjejnë mirënjohje dhe ndaj kritikut letrar Shpendi Topollaj, krijimtaria e të cilëve është e përfshirë në analizat dhe kritikën letrare të tij në shumë përmbledhje, ku shquhet objektiviteti dhe dashamirësia për veprat e kolegëve të tij.

Qendra e Personel Rekrutimit

Akademia e Forcave të Armatosura: 50 të drejta studimi për vitin akademik 2021-2022

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatët për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2021-2022, për 50 (pesëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimiti universitar i përafrohet si vijon: Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik), Xhenio/Infrastrukturë (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Forcë Ajrore (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatikë dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera). Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Aplikanti duhet të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të mos ketë probleme me deportimin; të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkoolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (1 gusht 2022). Përfundim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (1 gusht 2022); të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të plotësojë kushtin e sigurisë; të zotërojë diplomën e arsimit të lartë, (minimumi beachelor) të kryer brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë); të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepaticke, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislativitetit në fuqi. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e FA-së (nga radhët e ushtarëve dhe nënoficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet: të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të




mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

Procedurat e aplikimit

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë Qendrës së Personel Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e ushtarëve/detarëve apo nënoficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t'ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandim për pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumen-



tacionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit: kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksin A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve;

fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar

Datat e testimit:

Datat e testimit për aplikantët janë përcaktuar si vijon: testi i gjuhës së huaj (anglisht) është më datë 10.08.2021, testi fizik është më datë 11.08.2021, testi intelektual është më datë 12.08.2021 dhe testi psikologjik është më datë 12.08.2021.

Shenim: Aplikanti deklaron dhe firmos se të dhënat e paraqitura në formularëpërkatësjanë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.



QPR rekruton kandidatë për studime

Pesë (5) kandidatë për studime në shkollat e larta ushtarake të Greqisë

*Tre bursa për mjekësi, një për oficer tokësor dhe një për oficer detar.
Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 21 qershor 2021*

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë, 5 (pesë) të drejta studimi si më poshtë vijon: Shkolla e Studentëve për Oficerë të Forcës Tokësore "EVELPIDON", gjitharmësh, 1 (një) kuotë. Shkolla e Studentëve për Oficerë të Forcës Detare "SND", luftëtar, 1 (një) kuotë. Shkolla e Studentëve për Oficerë të Shërbimeve (të trupës) të Forcave të Armatosura "SSAS", për degën e mjekësisë, 3 (tre) kuota. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 21 qershor 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të ketë shtetësi shqiptare. Të mos jetë dënues nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në ndjekje penale. Të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera. Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të ketë kryer shkollën e mesme ose të jetë në vitin e fundit të saj. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë dokumentat e përfundimit të arsimit të mesëm. Kandidatët që janë duke ndjekur studimet në vitin e fundit duhet të paraqesin një vërtetim mbi rezultatet e dy viteve të para. Në përfundim të studimeve duhet të paraqesin diplomën dhe certifikatën e notave. Të ketë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm, jo më pak se 7 (shtatë). Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 cm për femrat. Të mos jetë i martuar. Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze, mbi 60 pikë në testimin ALCPT. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë nga sëmundje të zemrës, veshkave, hepatite, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike. Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë shkollave ushtarake jashtë vendit, me qëllim



pranimin në shkolla ushtarake. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen si dhe të ketë bërë të gjitha vaksinat dhe të mos jetë mbartës i sëmundjeve ngjitëse. Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit. Të plotësojë kushtin e sigurisë. Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake. Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit, kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e



studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato, kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më

sipër, s'kualifikohet.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë dhe preferenca e degës për të cilën aplikohet. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografji për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shën-

detësore të vendbanimit i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike. Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve:

Kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve duhet të paraqesin dëshmi penalteti, vërtetim nga gjykata, vërtetim nga prokuroria, vërtetim nga përmbarimi, ekzaminimet për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake por edhe testet për lëndët narkotike të lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Datat e testimit:

Ndërsa aplikanti do të kalojë katër teste në datat e përcaktuara. Kështu testi i gjuhës së huaj (anglisht) do të zhvillohet më 23 qershor 2021. Testi fizik do të zhvillohet më 23 qershor 2021. Testi intelektual do të zhvillohet më 24 qershor 2021 dhe testi psikologjik do të zhvillohet më 24 qershor 2021.

Shënim: Aplikanti duhet të deklarojë se të dhënat e paraqitura në formularët e plotësuar janë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.



“Zoti i luftës në qiell”, bombarduesi më i ri bërthamor kinez

Kina po punon për të pasur sa më shpejt gati një avion bombardues i cili mund të jetë në gjendje të ndërmarrë sulme bërthamore deri në territorin amerikan të Guamit dhe ndoshta edhe më larg.

Avioni Xian H-20 është thuhet gati për testime, pas publikimit të disa fotove dhe videove nga Korporata Shtetërore e Mbrojtjes në Kinë, Norinco. Për këtë projekt, Kina po punon prej vitesh, thonë analistët ushtarakë.

Sipas pamjeve të paraqitura, avioni kinez i ngjan atij amerikan USAF B-2 Spirit, i prezantuar fillimisht në vitet 1990. Në faqen

kryesore të revistës së Norinco-s, “Lufta Moderne”, avioni është etiketuar si “Zoti i luftës në qiell”.

Avioni peshon 200 tonë dhe mund të mbajë deri në 25 tonë armatime, ndërsa shpejtësia maksimale arrin diku më pak se 980 km/h. Jon Grevatt, një ekspert dhe analist i çështjeve ushtarake për zonën e Azi-Paqësorit, tha për “South China Morning Post”: “Ky mjet luftarak ajror përbën një përparësi strategjike, pasi Kina do të jetë në gjendje të godasë kundërshtarit në distancë të largët. Nëse nis përdorimi i gjerë, ky avion mund të ndryshojë “lojën” në atë territor”.



Kostoja e raketës është rreth 40 000-50 000 dollarë

Çfarë është “Kupola e Hekurt” që mbron hapësirën ajrore të Izraelit

Që prej ditës së parë të sulmit me raketa mbi Gaza, në rrjetet sociale janë shpërndarë foto të sistemit Izraelit të mbrojtjes ajrore. Në to shfaqet qielli i ndezur i natës mbi Izrael, pikërisht asaj që njihet si Kupola e Hekurt.

Çfarë është Kupola e Hekurt?

“Iron Dome” është një sistem me shumë misione i aftë për të kapur raketa, artileri, mortaja dhe Municione të Drejtuara me Precizion si sisteme mbrojtje ajrore me rreze shumë të shkurtër (V-SHORAD) si dhe aeroplanë, helikopterë dhe mjete ajrore pa pilot (UAV) për distanca të shkurtra lart deri në 70 km. Ai është një sistem që funksionon në të gjitha kushtet e motit dhe mund të përfshijë objektiva të shumëfishtë njëkohësisht dhe të vendoset mbi tokë dhe det. “Iron Dome” është prodhuar nga “Rafael Advanced Defense Systems” Limited dhe ka qenë në shërbim me Forcën Ajrore Izraelite që nga viti 2011. Sistemi i radarëve është zhvilluar nga Elta. Zhvillimi i tij u nxit pas një serie sulmesh me raketa ndaj Izraelit nga Hezbollah dhe Hamas në vitet 2000. Në luftën e Libanit 2006, rreth 4.000 raketa u hodhën në pjesët veriore të Izraelit duke rezultuar në vdekjen e rreth 44 civilëve izraelitë dhe evakuimin e rreth 250.000 qytetarëve sistemi u zvogëluar.

Si funksionon?

